

UDHËZIM
Nr. 7, datë 25.2.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 10.3.2014 “PËR PLANIFIKIMIN
E FONDEVE TË PAGESAVE PËR AFTËSINË E KUFIZUAR”**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014 , datë 27.11.2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, pikës 27 të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", të ndryshuar, të vendimit nr. 277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", të ndryshuar, të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të ndryshuar dhe pikës 11 të vendimit nr. 404, datë 20.6.2012 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e masës, të kriterëve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit, dhe invalidit paraplegjik e tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse", të vendimit nr 8, datë 14.1.2015 të Këshillit të Ministrave “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga heqja e fashës deri në 300 kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike”, udhëzimit nr 2, datë 6.2.2012, të Ministrisë së Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe udhëzimit plotësues nr. 2, datë 9.1.2015 të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit 2015”,

UDHËZOJ:

1. Në pikën 3, paragrafi i dytë riformulohet me këtë përmbajtje:

"Për të gjitha kategoritë mbahen parasysh pagesat e diferencuara që përfitojnë individë të veçantë për periudhën kur ndjekin arsimin e mesëm, të lartë apo pasuniversitar, pagesave për kompensimin financiar për energjinë elektrike, telefoninë fikse, pagesave për kompensimin për heqjen e fashës deri në 300 kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike, pagesën për paketën higjieno-sanitare.

Të dhënat e mësipërme plotësohen sipas mod. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi”.

2. Në pikën 10, shprehja “sipas pikës 8”, zëvendësohet me shprehjen “sipas pikës 9”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Velia**

Moduli 1

QARKU _____
BASHKIA, KOMUNA _____

Programimi i fondeve për pagesat e aftësisë së kufizuar

Datë, më _____

Nr	Emërtimi	Numri i personave PAK	Masa e pagesës	Fondi vjetor
I	Personat me aftësi të kufizuar gjithsej (a+b+c) + kujdestar			
1	Me aftësi të kufizuar mendore, fizike gjithsej (a+b+c)			

a	100%			
b	200%			
c	300%			
d	Kujdestarë gjithsej			
	100%			
	150%			
II	Të verbër gjithsej (a+b+c+d)+ kujdestar			
2	Të verbër gjithsej (a+b+c+d)			
a	100%			
b	150%			
c	200%			
d	300%			
	Numri kujdestarëve			
	Kompensim energjie verbër me kujdestar			
	Kompensim energjie verbër pa kujdestar			
	Kompensim telefoni për të verbër gjithsej			
	Kompensim për heqjen e fashës deri 300kwh			
III	Para e tetraplegjik+kujdestar+pakete H.S			
3	Para e tetraplegjik, gjithsej			
a	100%			
b	200%			
c	300%			
d	Kujdestarë gjithsej			
	100%			
	150%			
e	Paketa hijeno-sanitare			
	Kompensim energjie para e tetraplegjik me kujdestar			
	Kompensim energjie para e tetraplegjik pa kujdestar			
	Kompensim telefoni për para e tetraplegjik gjithsej			
	Kompensim për heqjen e fashës deri në 300kwh			
IV	Nr. i invalidëve gjithsej (a+b+c+d)			
a	Sëmundje e përgjithshme, grupi I			
b	Sëmundje e përgjithshme, grupi I I			
c	Sëmundje profesionale, grupi I.			
d	Sëmundje profesionale, grupi II			
	Totali i PAK			

ADMINISTRATORI

KRYETARI